

KUPTIMI, KRIJIMI, NDRYSHIMI DHE SHUARJA E HIPOTEKËS

ABSTRAKTI

Hipoteka është krijim i interesit në pasurinë e palujtshme të debitorit, përmes së cilës kreditori e realizon kërkesën e vet. Hipoteka siguron pagesën e detyrimit kryesor, kamatat, dhe taksat që i ka borxh kreditori hipotekar sipas kushteve të dokumentit të hipotekës si dhe çdo shpenzim të shkaktuar nga pengmarrësi si rrjedhim i procedurave të ekzekutimit të hipotekës.

Mbi hipotekën si e drejtë e sigurimit sendor janë paraparë një tërësi e dispozitave ligjore të shpërndara në ligje të ndryshme, si në LPDTS, LMD dhe Ligjin për Hipotekat, andaj kuptimi i vërtetë i aspekteve të hipotekës mund të arrihet duke iu qasur këtyre ligjeve në mënyrë kritike, ashtu edhe dispozitat tjera koresponduese e sidomos të atyre të LPP-së. Karakteristikat kryesore të hipotekës janë: Është e drejtë sendore; Themelohet vetëm mbi paluajtshmëritë; Siguron kërkesat; E drejta e hipotekës nuk parashkruhet; Është e drejtë aksesore; Për krijimin e saj kërkohet formë e posaçme etj.

Sipas të drejtës së Kosovës hipoteka, për nga mënyra e themelimit, mund të jetë: e kontraktuar, ligjore dhe gjyqësore. Zbatimi praktik i dispozitave ligjore mbi hipotekën në Republikën e Kosovës shihet përmes trajtimit të rasteve të zgjedhura, ku përfshihen tematikat kryesore që e preokupojnë sigurimin sendor përmes hipotekës.

Metodat e studimit: historike, normative, analitike, komperative.

Fjalët çelës: hipoteka, sigurimi sendor, kërkesa, kontrata